

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari i vetëm Zijadin Spahiu, me bashkëpunëtor profesional Ali Kryeziu, në lëndën penale kundër të akuzuarit N.D. për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën parag. 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe vepra penale kanosje nga neni 185 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.1536/13 të dt.20.08.2013, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e hapur gjyqësor mbi pranimin e fajësisë dhe publikimin e aktgjykimit më datë 23.08.2016, në prani të Prokurorit të Shtetit Ismet Ukshini, shpalli dhe komunikoi publikisht, ndërsa më datën 13.09.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :N.D.

Është fajtor

-I-

Më datën 21.07.2013 rreth orës 22:15,min. në rrugën kryesore në Kamenicë përballë ,, Pro Credit Bank,,i pandehuri pas një fjalosje – mosmarveshje të shkurtër me të dëmtuarin L.L. e sulmon së bashku me dy shokët e tijë F.dhe L. ashtu që fillimisht I pandehuri I pare N.D. derisa I dëmtuari po ecte në rrugë, e godet me krah në trup kurse kur I dëmtuari kthehet përballë të pandehurit N., ky e godet me dy shuplaka në fytyr kurse nga pas të pandehurit F.dhe L. e godasin me grushta ndër pjesë të ndryshme të trupit përderisa I pandehuri Fisnik pos që e godet edhe e mban për trupi duke mundësuar që të pandehurit N. dhe L. ta godasin lirshëm të dëmtuarin kurse si pasojë e goditjeve të marra I njëti detyrohet që të kërkojë ndihmë mjeksore në QKMF në Kamenicë.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim I leht trupor nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me aragrafin 4, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së

-II-

Më datë 21.07.2013, rreth ores 22:30 h, në Kamenicë, I pandehuri ka kanosur seriozisht të dëmtuarin F. L. në atë mënyrë që pas ngjarjes së përshkruar në dispozitivin e pare të kësaj aktakuze I pandhuri N posa është takuar në rrugë I është drejtuar F (xhaxhai I të dëmtuarit L. L.) me fjalët „mos më kshyr shtremt se ta la thikën në shpinë,, dhe ka filluar të ia ekspozoj thkën , me qka seriozisht ka kanosur të dëmtuarin dhe tek I njejt i ka shkaktuar ndjenjën e fikësimit dhe ankthit mbi dëmtimin e rendë trupor apo privimin nga jeta.

-me çka ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 lidhur me aragrafin 2 dhe 1 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit 4, 41, 46, 62, 73, 75, 76 të KPRK-së, si dhe nenit 463, 453 lidhur me nenin 365 të KPRK-së, të akuzuarin,

## E g j y k o n

Për dispozitivin

-I-

- Me denim me gjobë prej 220 (dyqindë e njëzet euro) €, të cilin denim ka për ta paguar në afatin prej 15 dite nga plotëfuqishmëria e aktgjykimit, apo nëse nuk e paguan denimin me gjobë i njejt i do ti zëvendësohet me denim burgu duke llogaritur 1 (një) ditë vuajtje të dënimit në vlerë prej 20 €.

Për dispozitivin

-II-

- Me denim me gjobë prej 180 (njëqin e tetëdhjetë euro) €, të cilin denim ka për ta paguar në afatin prej 15 dite nga plotëfuqishmëria e aktgjykimit, apo nëse nuk e

paguan denimin me gjobë i njejtë do të zëvendësohet me denim burgu duke llogaritur 1 (një) ditë vuajtje të dënimit në vlerë prej 20 €.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në contest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 15 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Përgjithshme në Gjilan, me aktin akuzues PP.II.Nr.1536/13 të datës 20.08.2013, ka akuzuar N.D., për shkak të veprave penale: lëndim I leht trupor nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me aragrafin 4, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe vepra penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 lidhur me aragrafin 2 dhe 1 të KPRK-së

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim gjyqësor në të cilën séance kanë prezentuar Prokurori i Shtetit Ismet Ukshini dhe i akuzuari.

Prokurori i Shtetit Ismet Ukshini, I ka propozuar gjykatës që të akuzuarin N.D. ta shpall fajtor dhe ta ndëshkojë sipas ligjit duke marrë parasysht rrethanat lehtësuese dhe ato renduese.

Pas leximit të aktit akuzues i akuzuari N.D. ka pranuar se ka kryer këto vepëra penale dhe ka pranuar fajësinë, për veprat penale siq ceket në aktin akuzues.

Gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPRK-së dhe i akuzuari në mbrojtjen e vet ka pranuar fajësinë.

Gjyqtari i vetëm ka vlerësuar se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe pranimi është bërë pasi që i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit nga i pandehuri mbështetet në faktet e qështjes që përmban akti akuzues si në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit si dhe nga dëshmia e dëshmitarëve të paraqitur nga prokurori i shtetit, akti akuzues poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë qështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin N.D. gjykata i ka marrë parasysht të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 të KPK-së.

Për të akuzuarin N.D. gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veqanarisht lehtësuese të cilat rrethana tregojnë se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 52 të KPRK-së. Si rrethana veqanarisht lehtësuese gjykata i mori faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimi dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin, sjellja korrekte në gjykatë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori, se i akuzuari është kryes i veprave të tjera penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe pasojat e shkaktuara.

Me dënimin e shqipëtuar gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që kryesit do t'i parandalohet që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 parag. 1, parag. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
-DEGA NË KAMENICË,  
Më datën 13.09.2016.

Bashkëpunëtor profesional,  
Ali Kryeziu ,d.v.

Gj y q t a r i,  
Zijadin Spahiu,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.